

ANALIZË LEKSIKORE DHE TERMINOLOGJIKE E TEKSTEVE SHKOLLORE TË LËNDËS GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI PËR KLASAT 6-9 NË KOSOVË

Rezyme

Objekt i studimit tonë është leksiku i teksteve shkollore të Gjuhës shqipe dhe leximit letrar për kl. 6-9. Brenda teksteve letrare dhe joletrare të përfshira këtu është vjelë, diskutuar dhe vlerësuar leksiku, si njësi përmbajtjesore, kuptimore, stilistike, me qëllim përcaktimi të vlerave gjuhësore që ka qenë synim i identifikimit të modaliteteve të perceptimit të tij nga grupmoshat e caktuara në shkollat tona.

Në rrafshin deskriptiv fillimisht është bërë hulumtimi i përmbajtjes së leksikut të përfshirë në tekstet letrare, me synim identifikimin e plotë të pasurisë leksikore që kanë ato dhe me qëllim matjeje të tij në interes të perceptimit leksikor e semantik të tij brenda një a më shumë vitesh. Në rrafshin gramatikor, në të vërtetë në rrafshin strukturor, leksiku është parë në thelb e gjerësisht nga aspekti fjalëformues. Në një kapitull më vete është bërë tipologjia e korpusit të plotë të tij, qoftë si formim i brendshëm, ashtu edhe si fjalës i huazuar. Qysh nga kërkimet fillestare kishim konstatuar një pasuri leksikore modeste, por prej shquarsisë fjalëformuese të tij, mund të themi se ai përfaqëson një pasuri të rëndësishme të leksikut historik dhe bashkëkohor të shqipes.

Para se të fillonim praktikisht për ta shkruar punimin, pikënisje kishim grumbullimin e teksteve të nevojshme, studimet gjuhësore nga kjo, tutje grumbulluam edhe materiale të tjera të nevojshme si fjalorë, enciklopedi etj. , me qëllim që ta realizojmë sa më mirë disertacionin tonë. Studimi ynë ka përfshirë serinë e plotë të teksteve shkollore të gjuhës shqipe dhe të leximit letrar për klasat 6-9 në Kosovë të të tri shtëpive botuese. Trajtimin teorik të materialit e kemi bërë duke u përpjekur që përshkrimi dhe shtjellimi shkencor mbështetur mbi një një literature të mjaftueshme.

Krijimtaria letrare e krijuesve letrarë që dokumenton gjuhën e shkruar dhe të folur në periudha të ndryshme kohore, ka qenë në interes të gjuhëtarëve të ndryshëm dhe gjithashtu në këto tekste të gjuhës dhe leximit letrar kemi një numër të konsiderueshëm krijuesish letrarë që janë të pranishëm me shkrimet e tyre letrare që nga letërsia e vjetër deri te ajo moderne. Në

tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe leximit letrar për klasat kl. 6-9 kemi praninë e leksikut të huaj që një pjesë e tij është përdorur nga krijuesit letrarë në poezitë, novelat, fragmentet e tyre për çështje stilistike, për ngjyrimet emocionale pozitive a negative. Së këndejmi, një pjesë e fjalës të huaj është përdorur si nevojë e gjuhës shqipe apo për shkak të mungesës së fjalës shqipe. Pjesa më e madhe e leksikut të huaj në tekstet letrare u përket fushave të lëvizshme, si fushës së ekonomisë, administratës, urbanistikës, fesë, zakoneve, veshjeve, kulturës, kuzhinës, sportit. Shumë fjalë të huaja që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhët e huaja janë përvetësuar prej saj, janë bërë pronë e përbashkët e shqipes, gjithashtu në gjuhën shqipe janë krijuar shumë fjalë të reja me anë të parashtesash e prapashtesash që ne i kemi analizuar veç e veç si: ndajshimin me parashtesa, prapashtesa, me parashtesa dhe prapashtesa njëkohësisht si dhe parashtesat e huaja dhe prapashtesat e huaja që në këto tekste shkollore të gjuhës shqipe dhe leximit letrar kanë një prani simbolike, kurse disa fjalë të reja (neologjizma) që janë krijuar në letërsinë tonë të vjetër e deri te Rilindja Kombëtare kanë dalë nga përdorimi dhe tani nuk njihen më si neologjizma.

Gjuha e këtyre teksteve letrare është në nivele të kënaqshme dhe sipas normës letrare. Të gjitha tekstet letrare iu përshtaten grupmoshave dhe gjithashtu gjuha e shkrimeve në këto tekste shkollore është e qartë dhe në përputhje me moshën e nxënësve, për të cilat janë vlerësuar si tekste dhe përmbajtje. Në aspektin leksikor dhe kognitiv nxënësit nuk e njohin aq shumë leksikun e vjetër të letërsisë sonë si dhe leksikun e bejtexhinjve për shkak të përdorimit të disa orientalizmeve, por për këtë kemi realizuar një anketim me nxënësit e kl. 6-9 për fjalët e panjohura dhe përpos këtyre, nxënësit nuk i njohin edhe disa fjalë të huaja janë futur vonë në leksikun e gjuhës shqipe. Gjuha shqipe është e hapur përballë gjuhëve të huaja, sidomos përballë ndërkombëtarizmave, kjo vërehet dhe në leksikun e teksteve shkollore të gjuhës dhe leximit letrar ku kemi një numër fjalësh nga fusha të ndryshme, si ajo e informatikës, sportit, kulturës, ekonomisë, administratës, artit, që në gjuhën shqipe janë futur së bashku me konceptet e që vetë gjuha shqipe kishte nevojë për to, dhe përveç anglishtes në këto tekste kemi disa orientalizma që janë futur shumë herët në gjuhën shqipe, ku një numër i tyre është futur së bashku me konceptet dhe po ashtu janë zhdukur së bashku me to, ndërkaq një numër i tyre është përdorur nga krijuesit letrarë (më tepër për çështje stilistike). Në këto tekste të gjuhës dhe leximit letrar, disa fjalë krahinore janë në fjalorin aktiv të gjuhës shqipe, por si ndarje e leksikut në aktiv dhe pasiv, ka vlerë më shumë relative, sidomos kur lidhen me grupet shoqërore dhe profesionale.

Tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe leximit letrar për kl. 6-9 janë tekste të cilat ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e kompetencave gjuhësore në të gjitha fushat e mësimit gjuhësor, si: drejtshkrim, gramatikë, të folur e mbi të gjitha në aspektin njohës leksikor. Në këtë disertacion jemi munduar ta paraqesim strukturën e plotë të këtyre teksteve shkollore, si strukturën dialektore; fjalëformimin, fjalë të formuara me ndajshesa, parashtesa, prapashtesa, parashtesa dhe prapashtesa të huaja; fjalë të përbëra dhe të përngjitura; leksikun e autorëve të vjetër dhe më kryesorë të këtyre teksteve shkollore dhe jo në tërësinë e tij; leksikun e autorëve kryesorë të Rilindjes Kombëtare që janë pjesë e këtyre teksteve shkollore dhe jo në tërësinë e tij; leksikun e autorëve kryesorë të gjysmës së parë të shekullit XX, që është pjesë e këtyre teksteve dhe jo në tërësinë e tij; leksikun e autorëve kryesorë të letërsisë moderne që është pjesë e këtyre teksteve shkollore dhe jo në tërësinë e tij; leksikun e huaj që është përdorur nga krijuesit letrarë qoftë si nevojë për çështje stilistike apo për ngjyrimë emocionuese negative dhe pozitive; semantikën e leksikut të këtyre teksteve, pra, sinonimet, antonimet dhe homonimet; leksikun e gjuhës letrare dhe përdorimin stilistik në këto tekste shkollore; fjalorthin e fjalëve të rralla; shtesën e fjalëve të reja; veçoritë e leksikut të librave shkollorë; leksikun terminologjik të këtyre teksteve; fjalorthin e leksikut të librave të gjuhës shqipe dhe leximit letrar për kl. 6-9; problemet e nxënies së leksikut nga nxënësit si dhe anketën me nxënës për fjalët e panjohura. Qasja jonë është burimore pasi gjer më tani nuk ka pasur ndonjë studim për leksikun e teksteve shkollore të gjuhës shqipe e të leximit letrar për kl. 6-9. Nga ana e përmbajtjes, si dhe sa u përket aspekteve didaktike të lëndëve në fjalë tekstet dhe ushtrimet e përmbledhura në këto tekste tregojnë një nivel të mirë, bashkëkohor dhe janë në përputhje me temat e trajtuara dhe aktuale për sa i takon trajtimin metodik. Për realizimin e disertacionit tonë jemi mbështetur mbi një literaturë teorike, kurse tekstet shkollore të gjuhës shqipe dhe leximit letrar për kl. 6-9 kanë qenë një burim shumë i rëndësishëm për studimin e leksikut të këtyre teksteve. Ky disertacion ka një rëndësi të veçantë pasi që dokumentohet përmbajtja e leksikut të librave të gjuhës shqipe dhe leximit letrar të të tri shtëpive botuese për kl. 6-9 në Kosovë. Qëllimi është që, duke vështruar këtë domen me tërë gamën e tij leksikore të plotësojmë një boshllëk në gjuhësinë shqiptare, ku do të bëhet përshkrimi dhe vështrimi i leksikut në tërësi dhe do të vilet drejtpërdrejt nga tekstet e zgjedhura. Ne mendojmë se do t'i japim studimit vlerën e veçantë shkencore, në mënyrë që me këtë studim të përmbushim qëllimin për të sjellë rezultate të reja dhe të dobishme shkencore, të cilat do të jenë me interes për studiuesit dhe me peshë të veçantë për leksikologjinë shqiptare. Theksojmë që

këtë disertacion hëpërhë nuk do ta karakterizojë prirja për të qenë shterues. Historia e leksikografisë shqipe i ka kaluar më shumë se tre shekuj e gjysmë. Por, me gjithë disa artikuj e shënime të rëndësishme, ku vlerësohet trashëgimia, arritjet shkencore dhe ndriçohet rruga e përshkruar, pamja e plotë e kësaj historie vazhdon edhe me studimin e veprave dhe qasjeve burimore siç është ky disertacion: *Analizë leksikore dhe terminologjike e teksteve shkollore të lëndës gjuhë shqipe dhe letërsi për klasat 6-9 në Kosovë*. Materiali duke qenë i marrë në shqyrtim jashtëzakonisht gjerësisht, do të mundohem që realizimin e disertacionit ta bëj në mënyrë sa më të mirë. Teza e propozuar, si e tillë nuk është trajtuar deri më sot në gjuhësinë tonë. Për përcaktimin e kësaj teze hulumtuese janë marrë disa faktorë me rëndësi që çështja që trajtohet të sjell risi. Skema përfundimtare do të përmbajë: përcaktimin e titullit, skemën e parathënies dhe skemën e pjesës themelore të studimit.

Gjatë skicimit të studimit do të gjejnë vend këto elemente: synimet e mia të cilat janë vështruar e analizuar hollësisht në hulumtim; çështjet e trajtuara në hulumtimet e mëhershme dhe problemet e pashtjelluara që lidhen me temën dhe studimin tim; shfrytëzimi i burimeve shkencore; çështjet që trajtohen në secilin kapitull veç e veç. Çdo punim i karakterit shkencor duhet të bazohet në metoda të mirëfillta shkencore dhe për realizimin e tij do të përdorim këto metoda, si: Metoda e analizës teorike, metoda deskriptive-përshkruese, metoda krahasimtare; metoda statistikore, metoda e anketimit të nxënësve. Ky disertacion bazohet në metodat më të përshtatshme që lidhen me natyrën dhe karakterin e temës e cila do të jetë synim i këtij studimi. Me një gërshetim të këtillë metodash hulumtuese mendojmë se punimi ka sjellë rezultate me vlerë shkencore për një aspekt të rëndësishëm siç është disertacioni: *“Analizë leksikore dhe terminologjike e teksteve shkollore të lëndës gjuhës shqipe dhe letërsi për klasat 6-9 në Kosovë”*. Me këtë studim do të begatohet fusha e leksikologjisë si një nga shkencat më të rëndësishme të gjuhësisë. Nga këto metoda, përdorim më të madh do të ketë metoda e analizës statistikore dhe krahasuese me të vetmin qëllim, pra, për të arritur përfundimin e mirëfilltë synues shkencor.

Fjalët kryesore: leksik, terminologji, gjuhë, letërsi, tekst, shkollë, klasë.

LEXICAL AND TERMINOLOGICAL ANALYSIS OF THE TEXTBOOKS OF THE ALBANIAN LANGUAGE AND LITERATURE FOR GRADES 6-9 IN KOSOVO

Resume

The subject of our study is the lexicon of Albanian language in textbooks and literary reading in the schools for class from 6 to 9. Within the literary and non-literary texts is included here, the vocabulary has been collected, discussed and evaluated as a substantive, meaningful, stylistic unit in order to determine its linguistic values and to identify modalities of its perception by certain age groups in our school.

In the descriptive context, the substantive research of the lexicon included in literary texts was initially undertaken with the aim of fully identifying the lexical richness that they possess and for measuring it in the interest of its lexical and semantic perception within one or several years.

Before we started to write the containment in practice, first we started to assemble up the necessary material, after that we assembled up the necessary material from studies linguistics and different albanologist scholars. On purpose to realize our better dissertation and after assembling up the necessary material we finished the project and we started with text reading which is the main key to realize our dissertation were. Our study has contained the full serious of school texts from Albanian language and the literature reading for the classes from 6-9 in Kosovo from 3 publisher houses.

The theory treatment of the material that we have done, trying to approximate the prescription and the scientific elaboration with enough literature to end up our dissertation with success. The creativity literary of literary creators which documents the written and spoken language in different periods of time, has been in interest of different linguists and also in these texts of language and literary reading we have considerable number of literary creators who are present with their literary writings from the old literature until the modern literature.

In the textbooks of Albanian language and literary reading for the grades 6-9, we have the presence of the foreign vocabulary, which also was used from the literary creators in poetry,

novels, their fragments for their stylistic purposes, exciting positive or negative manors, and also as a lack of foreign speech it has been used as needed for Albanian language or as a lack of Albanian missing words. The biggest part of international lexicon in the literary texts it belongs to the moving fields such as: the field of economy, culture, sports etc. Many foreign words which have become part of Albanian language from international languages have been adopted from it, they have become a united property of Albanian language.

Albanian language has created a lot of new words with prefixes and suffixes which we did carefully analyze part by part with submissions and prefixes. Suffixes, at the same time the foreign prefixes and foreign suffixes which ones in these textbooks of Albanian language and literary writing have a symbolic presence, while many new words (neologisms) that have been created in our old literature up to National Albanian Renaissance have become out of used, and now they are not known as neologisms.

The language of these literary texts is on a satisfaction level and based on the norms. The entire literary texts match with different ages, also the written language in these textbooks it is clear and in accordance with the age of students, for which they have been named and classified as texts and contents. In the vocabulary and cognitive manner, students don't recognize at all the old vocabulary of our literature also "bejtexhinjve"- lexicon because of some oriental words. For this case we have done a survey with students from 6-9 classes regarding to unknown words, some of the students we saw that they don't have any knowledge about new foreign words that now has become part of Albanian vocabulary. Albanian language is open in front of other foreign languages especially facing international words and this is noted in language and text vocabulary in school and also in the literary reading where we have few different words in different fields, such as: economies, administration, arts, cultures, sports that have been introduced into the Albanian language along with the concepts that the Albanian language itself needed. Also except English language in the texts we have a numerous of oriental words that have entered very early in Albanian language, where a number of them have entered together with the concepts, also later on they have disappeared together with them. Despite that a numerous of them have been used from literary creators mostly for the stylistic purposes. In these texts of literary and reading texts, few provincial words are in the active vocabulary of

Albanian language, but as an active and passive vocabulary breakdown has more relative value, especially when they connect with the social and professional groups.

The school textbooks of literary reading in Albanian language for the classes 6 to 9 are texts which in the very good manner affect in the language powers development in all language learning fields, such as: spelling, grammar, speaking and above that in lexical aspect. In this dissertation we have tried to present the full structure of these school textbooks, such: dialect structure: word formation, words created with affixes, prefixes, suffixes, foreign prefixes and suffixes: compound words and affixed words : lexicon of old authors and most important of these texts but not in its entirety: lexicon from the main authors of "National Albanian Renaissance", which are part of the school textbooks and not in its entirety; the lexicon of the main authors from the first half of the 20-th century, which is part of these texts but not in its entirety; lexicon of main authors from modern literature which is part of these school book texts, but not in its entirety; international lexicon which has been used from literary creator whether as a stylistic need or negative and positive exciting hues; lexical semantics of these texts, synonyms, antonyms and homonymous; lexicon of literary language and stylistic use in these school textbooks: glossary of rare words: addition of new words: vocabulary features of school books; terminological lexicon of these texts: lexical glossary of Albanian language books and literary reading for classes 6 to 9: problems of lexis learning from students also the survey with the students for the unknown words. Our case is sourced because until now there wasn't any study about the textbooks lexis of Albanian language for the classes 6 to 9. On the content side, also as it far as it goes the texts and the summarized exercises in these texts they show a good level, contemporary and they are relevant with the treated topics and actual regarding the methodical treatment. To realize our dissertation, we have been based on a theory literature, and Albanian textbooks and literary reading for the classes from 6 to 9 have been very important resources for the lexical study of these texts. This dissertation has a special importance because there is documented the content of the lexicon Albanian books and literary reading from three publishing houses for the classes 6 to 9. The purpose is that watching lexical range to fill a void in Albanian linguistic, where will be realized the lexicon description in general, and it will be harvested directly from the texts. We think that we will give a special scientific value to this study, so that in this study to fulfill the purpose to bring new results and scenically useful, which will be in the interest for the researchers and with a special request for Albanian lexicology. We

note that for this desertion for now will not be characteristic of the tendency to be exhaustive. The history of Albanian lexicography has passed more than three and a half centuries. Lexical and terminological analysis of school textbooks from the Albanian language and literature course for the classes 6 to 9. Being a taken material in extremely extensive review, I will try that reanimation of this desertion do in the best way. The masterpiece thesis was not tread until now as is in linguistic. For the defining this research thesis have been taken few important factors so the issue that is addressed to bring innovation. The final scheme will contain: title determination, foreword scheme and also basic scheme of study. This research will be based on a most appropriate which connects with study character which will be the goal of this research.

During the design of study will take place these elements: my intentions which will be elaborated in details in research: the treated issues in previous researches and also the unfinished problems which are connected to my topic and my study: exploration of scientific resources: issues that are treated in each chapter. Scientific research must be based in the authentic methods and for realization of this research we practices methods, such as theory analysis, descriptive method, comparative method: statistic method, and the survey method from students. With this mixture of methods, we think that our work has brought valuable results for an important aspect like desertion: "*Lexical and terminological analysis for Albanian language and literature textbooks for the classes 6 to 9 in Kosovo*".

With this study, the lexicology will prosper as one the most important scientific parts of linguistic. Based on these methods greater use will have statistical analysis method, comparative method, with the sole purpose to achieve the genuine goal.

Keywords: lexicon, terminology, language, literature, text, school class.